

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGM-SË, duke vepruar në bazë të parashtresës së Mençe Atanasova Toçit, udhëheqëse e sektorit në Fondin për Sigurim Shëndetësor FSSHM kundër sjelljes së Miroslava Burnsit , gazetare e Sloboden Peçatit, në seancën e datës 17.02.2023 solli këtë VENDIM
PARASHTRESA REFUZOHET PËR SHKAK TË MOSKOMPETENCËS SË KËSHILLIT, POR NJËKOHËSISHT SILLET
VENDIM PËR SITUATËN E KRIJUAR

ARGUMENTIM

Deri tek KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGM-SË ishte dorëzuar parashtresë nga Mençe Atanasova Toçi, udhëheqëse sektori në FSSHM, kundër Miroslava Burnsit, gazetare e Sloboden Peçatit, ndërsa kësaj i kishte paraprirë një korrespondencë dhe sqarime për një rast në të cilin Miroslava Burns ka kërkuar mbrojtje nga SHGM pasi ka vlerësuar se zyrtarja nga Fondi Shëndetësor ka vepruar në mënyrë selektive dhe në vend se të japë përgjigje në pyetjet e saj, përgjigjet i'a ka dhënë një redaksie tjetër.

Parashtruesi Mençe Atanasova Toçi ndërkohë thekson se ka qenë e dhunuar verbalisht dhe shqetësuar nga gazetarja Miroslava Burns e cila i ka dërguar mesazhe në Fejsbukun e saj edhe në mesnatë - e njofton SHGM-në dhe Këshillin e Nderit nëpërmjet një dokumenti zyrtar nga FSSHM se gazetarja Burns e ka keqpërdorur pushimin mjekësor që e ka pasur duke punuar në atë periudhë pushimi.

Duke shqyrtuar rastin, Këshilli i Nderit erdhi në përfundim se duhet ta hedh poshtë parashtresën pasi në rastin konkret, lëndë e kontestit nuk është një tekst gazetarie ku do të mund të kontrollohej shkelja eventuale e Kodeksit, por vetëm një narrativ për komunikim të të dy palëve.

Këshilli i Nderit nuk është polic Fejsbuku i cili duhet të kontrollojë se kush kujt i ka dërguar mesazhe dhe në çfarë kohe, por erdhi në përfundim se Miroslava Burns e cila është e pakënaqur nga sjellja e Fondit, respektivisht Mençe Atanasova Toçit, në rast se nuk kishte marrë përgjigje për pyetjen lidhur me informacion të karakterit publik, pas 30 ditësh ka qenë e DETYRUAR që të nisë procedurë para Komisionit që vendosë lidhur me ankesa për qasje deri tek informacionet me karakter publik, ndërsa më tej të bëj padi edhe para Gjykatës Administrative, organe këto të cilat nëse konstatojnë shkelje, mund të nisin edhe procedura kundërvajtëse dhe të shqiptojnë dënime.

SHGM në këtë fazë si një Shoqatë apo nëpërmjet Këshillit të Nderit, nuk mund të jetë ndërmjetësues në proces.

Procedura është e qartë, kompetentë janë Komisioni dhe Gjykata Administrative.

Në mënyrë shtesë, Këshilli i Nderit thekson se edhe kur gazetarët komunikojnë me persona përgjegjës për marrëdhënie me publik, dhe në përgjithësi në komunikimin publik, janë të obliguar që të mbajnë marrëdhënie profesionale duke respektuar nenin 15 nga Kodeksi i cili thotë : Gazetari patjetër ta kultivojë kulturën e të shprehurit dhe etikën. Komunikimi i pashembullt me opinionin nuk i ka hije profesionit të gazetarit.

.

KËSHILLI I NDERIT, poashtu shpreh një shqetësim serioz për keqpërdorimin e të dhënave personale nga ana e Mençe Atanasova Toçit që i ka theksuar në parashtresë, në të cilat raporton se derisa Miroslava Burns ka qenë në pushim mjekësor – ka punuar, me çka ka bërë keqpërdorim të pushimit mjekësor.

Në rastin konkret, bëhet fjalë për informacion që Mençe Atanasova Toçi nuk ka guxuar ta ndajë me persona të tretë, por nëse është informacioni i vërtetë, për këtë duhet ta njoftojë Inspektoratin kompetent i cili do ta vërtetojë keqpërdorimin dhe do ta sanksionojë autorin e shkeljes.

Në këtë mënyrë, Mençe Atanasova Toçi ka bërë shkelje të Kodeksit të Zyrtarëve Shtetëror, pasi ka shpërndarë të dhëna që i ka mësuar në kuadër të punës së saj, edhe pse nuk ka pasur të drejtë t'i dijë, dhe kështu e ka shkelur Kodeksin edhe më rëndë, prandaj Këshilli i Nderit i bën thirrje publike udhëheqësisë së FSSHM-së që të nisë procedurë disipline dhe të shqiptojë sanksione për shkak të shkeljes së rëndë të Kodeksit, dhe për këtë ta informojë opinionin.

Sipas detyrës zyrtare por edhe pas reagimeve të anëtarëve të SHGM-së, para së gjithash nga gazetaret femra që për momentin shfrytëzojnë pushimin e lindjes, KËSHILLI konstaton se parashtruesja Atanasova Toçi si udhëheqëse e sektorit në FSSHM ; siç pohon se e ka marrë përsipër komunikimin me gazetarët në mungesë të një zëdhënësi, ka hyrë në konflikt të hapur me gazetaret në rrjetet sociale pasi ata kanë publikuar statuse në të cilat kanë shprehur pakënaqësinë që pas një gjoja sulm kibernetik, Fondi nuk ua ka paguar të hollat për pushimin e lindjes, ndërsa udhëheqësia refuzon të paraqitet në media dhe të flet për këtë problem të pagesës së mjeteve në të gjitha bazat, prej pagave të mjekëve deri tek pagesa e të gjithë pushimeve mjekësore apo mjeteve për kompensim të pagesave për ilaçe.

Mençe Atanasova Toçi, si zyrtare shtetërore, është lëshuar në sulme direkte, duke akuzuar gazetaret – nëna, se po nxisin tensione në opinion, se kanë para apo se duhet të kenë pak durim sepse do t'i marrin paratë, gjë që shkaktoi një mori komentesh negative në rrjetet sociale.

Prandaj, Këshilli i Nderit pranë SHGM-së vlerëson se është e papranueshme që një zyrtar shtetëror, pavarësisht se a është gjatë apo jashtë orarit të punës, që të futet në komunikim të tillë publik, të etiketojë dhe të ofendojë, pasi kështu në mënyrë direkte shkel më shumë dispozita nga Kodeksi për Zyrtarë Shtetërorë.

Këshilli, përpos kërkesës për sanksionim të udhëheqëses së sektorit, kërkon distancim nga qëndrimet dhe komentet e Mençe Atanasova Toçit, kërkon emërimin e menjëhershëm të zëdhënësit të institucionit në mënyrë që të vendoset komunikim normal me mediet. Gjithçka tjetër do të ishte në dëm të qytetarëve të cilët janë të prekur nga situata në FSSHM, ndërsa nëpërmjet medieve do të mund të marrin informacionin e duhur në kohë dhe në mënyrë të saktë.

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGM-SË
Kryetar
SASHE DIMOVSKI

